



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

## Shqipëri-Kosovë: Memorandum bashkëpunimi për të drejtën e autorit

2017-11-27 10:08:00



Në Shtëpinë e Flamurit, një prej ndërtesave simbol të qytetit të Korçës, Qeveria e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë mbajtën një mbledhje të përbashkët, nën siglën "Një popull, një ëndërr". Qeveritë "Rama" dhe "Haradinaj" nisën mbledhjen e përbashkët, ku u diskutuan një sërë çështje që përfshijnë të gjitha fushat e bashkëpunimit mes Kosovës dhe Shqipërisë. Ministria e Kulturës znj. Mirela Kumbaro dhe Ministri Kujtim Gashi nënshkruan në Korçë një

memorandum bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Kulturës të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës.

Në Shtëpinë e Flamurit, një prej ndërtesave simbol të qytetit të Korçës, Qeveria e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë mbajtën një mbledhje të përbashkët, nën siglën "Një popull, një ëndërr". Qeveritë "Rama" dhe "Haradinaj" nisën mbledhjen e përbashkët, ku u diskutuan një sërë çështje që përfshijnë të gjitha fushat e bashkëpunimit mes Kosovës dhe Shqipërisë.

Ministria e Kulturës znj. Mirela Kumbaro dhe Ministri Kujtim Gashi nënshkruan në Korçë një memorandum bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Kulturës të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës.

Përpos shkëmbimeve dhe zgjerimit të hartës kulturore ky memorandum bashkëpunimi nënshkruhet edhe në një tjetër fushë të rëndësishme, jo vetëm për vendet tona, por edhe për integrimin tonë në Evropë, posaçërisht në fushën e të drejtave të autorit. Qarkullimi i vlerave dhe krijimtarisë kërkon me domosdo koordinimin e politikave dypalëshe për respektimin dhe standartizimin e copyright-it me praktikën më të mira evropiane. Nëpërmjet këtij Memorandumi të dyja palët institucionalizojnë politikën shtetërore për të shkëmbyer praktikën më të fundit në administrimin kolektiv të të drejtave të autorit dhe promovojnë të drejtat e artistëve shqiptarë e kosovarë në një treg të përbashkët në nocionin e kulturës pa kufij.

Ministria Kumbaro u shpreh se: "Hapësira jonë kulturore është e përbashkët, tregu i krijimtarive po ashtu. Na duhet të jemi bashkë në këtë llogorë. Mirëpresim çdo propozim të Ministrit Gashi, dhe do të ofrojmë çdo informacion juridik dhe administrativ për të ndërtuar një mjedis ku respektohet mbi të gjitha autori dhe sigurohet vazhdimësia e krijimtarisë artistike".

Ministri Gashi u shpreh i gatshëm të bashkëpunojë jo vetëm në fushën e të drejtës së autorit, por edhe në krijimin e një skene të përbashkët kulturore me Shqipërinë.

Kumbaro kujtoi se "Kalendari i përbashkët kulturor 2018, duhet të mbrohet nga kalendari i politikës që mund edhe ta eklipsojë kulturën, siç na duhet të pranojmë se na ndodhi këtë vit. Politika vete e vjen, kultura e njerëzit e saj mbeten, dhe sot po ne, politikanët e marrim këtë angazhim".

Një vit më parë, Ministria e Kulturës miratoi ligjin për të drejtat e

autorit dhe t? drejtat e tjera t? lidhura me të, një ligj pararojë dhe revolucionar që tashmë ka filluar të japë efektet e para pozitive, duke përmbushur kështu të gjitha detyrimet e fushës që burojnë nga Marrëveshja e Asociimit Stabilizimit me Bashkimin Evropian.